



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2019:202827
Datë: 24.02.2023
Numri i dokumentit: 04013982

PPP.nr.1/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit B.A., nga Ferizaj, rr “...”, nr..., të cilin e përfaqëson av Kushtrim Obrazhda nga Ferizaj, kundër debitorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) sh.a, me seli në Prishtinë, për pagesën e kompensimit të dëmit, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga debitori, me datë 24.02.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) sh.a, i ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.40/2023, të datës 26.01.2023, i lëshuar nga përmbaruesi privat Besnik Aliu nga Ferizaj dhe **MBETET** në fuqi urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.40/2023, i datës 26.01.2023.

A r s y e t i m

Me urdhrin P.nr.40/2023, të datës 26.01.2023, përmbaruesi privat Besnik Aliu, e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga kreditori B.A., kundër debitorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) sh.a, me seli në Prishtinë, për pagesën e kompensimit të dëmit dhe për shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 10,871.00 euro, me kamatë si për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar, e cila paguhet nga bankat komerciale të Kosovës, si dhe shpenzimet e procedurës së përmbarimit, në bazë të aktgjykimit

C.nr.374/19, të datës 12.09.2019, i lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj, ose ndalimin e mjeteve në para nga llogaria e debitorit dhe transferimin në llogari të kreditorit.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, debitori, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, duke i propozuar gjykatës që të pranohet prapësimi si i bazuar.

Kreditori ka ushtruar përgjigje me shkrim në prapësimin e debitorit, me të cilën i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim.

Gjykata i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin për përmbarim P.nr.40/2023, të datës 26.01.2023 dhe pretendimet në prapësim të debitorit dhe vlerësoj se prapësimi në fjalë është i pabazuar dhe nuk i plotëson asnjërin nga kushtet e parapara me nenin 71, par 1, të LPP-së.

Gjykata me rastin e rishikimit të procedurës së përmbarimit në rastin konkret, në bazë të nenit 43, par 4, të LPP-së, vlerësoj se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore të parapara me nenin 22, par 1, nën par 1.1, të LPP-së, për nxjerrjen e urdhrin për përmbarim P.nr.40/2023, të datës 26.01.2023, dhe se urdhri për përmbarim nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore ngase përmbaruesi privat në këtë rast e ka lejuar përmbarimin në pajtim të plotë me nenin 21 dhe 22, par 1, nën par 1.1, të LPP-së.

Sa i përket pretendimit të debitorit në prapësim se: propozimi për përmbarim i lejuar nga përmbaruesi privat është i përfshirë me të meta substanciale pasi që debitori ka pranuar vetëm kopjen e titullit përmbarues dhe se kjo gjë e bënë këtë urdhër për përmbarim të pa ligjshëm dhe rrjedhimisht të anulueshme pasi që propozimi për përmbarim nuk është bërë konform nenit 38, të LPP-së, gjykata këtë pretendim e konsideron të pabazuar sepse nga shkresat e lëndës konstatohet se kreditori bashkë me propozimin për përmbarim tek përmbaruesi privat e ka dorëzuar edhe aktgjykimin C.nr.374/19, të datës 12.09.2019, në origjinal. Andaj, gjykata konsideron se në këtë rast janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 36, par 1, të LPP-së. Po ashtu, nga propozimi për përmbarim i kreditorit konstatohet se i njëjti është përpiluar në pajtim me nenin 38, par 1, të LPP-së, që nënkupton se propozimi e përmban kërkesën për përmbarim në të cilën është treguar dokumenti përmbarimor në origjinal siq është aktgjykimi C.nr.374/19, i datës 12.09.2019, kreditorin dhe debitorin, adresën e vendbanimit të kreditorit dhe selisë së debitorit, objektin e përmbarimit si dhe të dhënat tjera

që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit. Përveç tjerash, përmbaruesi privat Besnik Aliu urdhrin për përmbarim të cekur më lart e ka nxjerrë në pajtim të plotë me nenin 22, par 1, nën par 1.1, të LPP-së dhe në bazë të aktgjykimit C.nr.374/19, të datës 12.09.2019, i lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj, i cili i plotëson të gjitha kushtet ligjore për tu cilësuar si dokument përmbarimor sepse i njëjti siç shihet është i plotfuqishëm nga data 07.10.2022 dhe i ekzekutueshëm nga data 26.01.2023, respektivisht është i pajisur me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri, kusht ky i kërkuar në nenin 36, par 1, të LPP-së.

Po ashtu, sa i përket pretendimit të debitorit në prapësim se debitori për arsye teknike nuk ka mundur ta përmbushë në afatin e caktuar këtë obligim dhe më datën 10.01.2023, kreditori ka ushtruar propozimin për përmbarim, gjykata edhe këtë pretendim e konsideron të pabazuar për arsye se kreditori propozimin e tij për përmbarim e ka ushtruar pas kalimit të afatit partitiv (vullnetar) siç është cekur në aktgjykimin e cekur më lart prej 15 ditësh për shkak të mosrespektimit nga debitori të këtij afati.

Gjithashtu, Gjykata vlerëson se në rastin konkret Gjykata Themelore në Ferizaj është kompetente për të vendosur në këtë çështje sipas prapësimit të debitorit, për shkak se kjo çështje është rregulluar shprehimisht edhe me dispozitat e nenit 109, paragrafi 3, të Ligjit për Procedurën e Përmbarimit ku citohet se : *“Për debitorin si person juridik kompetencë territoriale është Gjykata ku gjendet selia e personit juridik ose selia e njësisë organizative të tij, si dhe Gjykata në territorin që ka nxjerrë dokumentin përmbarues”* dhe në rastin konkret aktgjykimi C.nr.374/19, të datës 12.09.2019, në bazë të cilit është nxjerrë urdhri për përmbarim, është nxjerrë nga Gjykata Themelore në Ferizaj dhe duke e marrë parasysh këtë fakt, Gjykata konstaton se në rastin konkret nuk ka kurrfarë pengese ligjore që për prapësimin e debitorit të vendos Gjykata Themelore në Ferizaj.

Andaj, Gjykata duke i marr parasysh thëniet e debitorit në prapësim, thëniet e të autorizuarit të kreditorit në përgjigjen në prapësimin e debitorit, si dhe duke i marr parasysh provat dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoj se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi që të njëjtin ta refuzoj në tërësi si të pabazuar ndërsa urdhri për përmbarim P.nr.40/2023, i datës 26.01.2023, të mbetet në fuqi.

Nga të cekurat më lart dhe bazuar në nenin 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PPP.nr.1/23, më datë 24.02.2023

GJYQTARI

Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykates së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.